



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr. 56 / 2025

Datë: 18.04.2025

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrtari i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 68, nenin 69, paragrafi 1, nenin 71, paragrafi 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të njoftimit me nr. Protokolli 305, të parashtruar ndaj “Policisë së Kosovës”, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Urdhërohet** Policia e Kosovës, të ndërmerr masat e nevojshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale gjatë përpunimit të të dhënave personale.
2. **Këshillohet** Polica e Kosovës që përpunimin (publikimin) e të dhënave personale të bëjë në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Në afat prej 15 ditëve të njoftohet Agjencia për zbatimin e vendimit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimin të vendimit.

A r s y e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia), më datë 24.03.2025, ka pranuar njoftim që mbanë nr.prot. 305, të parashtruar nga ana e subjektit të të dhënave personale F. I, lidhur me atë se Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria e Prokurimit, në platformën E-Prokurimi, në dosjen e tenderit nr. 214-22-10936-5-1-1 136, me titull: Ndërtimi i Stacionit Policor Veri Prishtinë, është e publikuar dosja e tenderit e cila mund të shihet në këtë link: e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=3501583. Kjo dosje përmban disa dokumente, ku një ndër ta është edhe “Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim”, i datës 01.02.2024, i cili në vete përmban të dhëna personale të subjekteve të të dhënave, përfshirë datëlindje, numra telefoni, e-mail adresa, gjinia, kombësia si dhe numra personal. Sipas njoftimit të pranuar në Agjenci, kompania “ASTRAPLAN” ka kërkuar disa herë nga zyrtarët e Drejtorisë së Prokurimit të PK-së të largoj këto të dhëna nga publikimi. Bazuar në nenin 68, paragrafi 1, dhe nenin 69, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), Agjencia, pas pranimit të njoftimit, ka filluar procedurën e inspektimit për të

vërtetuar pretendimet e palës. Gjatë verifikimit të dëshmive është konstatuar se pas hapjes së linkut të bashkëlidhur hapet dosja e tenderit.

Më datë 25.03.2025, zyrtari i inspektimit i është drejtuar përmes postës elektronike zyrtarit përgjegjës në Policinë e Kosovës, duke kërkuar sqarime lidhur me atë se, a është pranuar ndonjë kërkesë për largimin e të dhënave nga publikimi, cila është baza ligjore që parasheh publikimin e këtyre dokumenteve, cili është qëllimi i publikimit të tyre dhe a është këshilluar drejtoria e prokurimit me ZMDhP-në për të marrë një mendim lidhur me publikimin e dokumenteve që kanë të dhëna personale.

Me dt.02.04.2025 AIP është njoftuar nga zyrtari përgjegjës në Policinë e Kosovës, duke deklaruar “Policia e Kosovës asnjëherë nuk ka pasur kërkesë nga pala për largimin e këtij vendimi, publikimi i këtyre të dhënave është adresuar tek Operatori Ekonomik, ankues pasi që këtë staf e ka prezantuar OE dhe është trajnuar dhe adresuar tek OE, ne sistem të E-prokurimit tek skedari kërkesa për rishqyrtim aty është i ngarkuar Vendimi. Gjithashtu vendimi është ngarkuar edhe tek skedari dokumente shtojce i cili në mënyrë automatike ka publikuar vendimin duke theksuar, se ky vendim është ngarkuar tek dokumentet shtojcë e qe sistemi ka proceduar me publikimi. Gjithashtu Drejtoria e Prokurimit nuk është këshilluar me ZMDhP, pasi që kjo është trajtuar për tu adresuar vetëm tek OE, ankues mbi stafin e prezantuar në oferte sipas kërkesë për rishqyrtim. Drejtoria e Prokurimit në moment të pranimit ka marrë masë për largim të këtij vendim nga platforma dhe ka adresuar kërkesë Helpdesk Eprokurimi.Helpdesk@rks-gov.net për largim të këtij dokumenti të publikuar”. Me qëllim të vërtetimit të deklaratimit të kontrolluesit, zyrtari i inspektimit ka kontrolluar dosjen ku ka qenë i publikuar dokumenti me të dhëna personale dhe konstaton se i njëjti është larguar nga kontrolluesi.

Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMSHP), përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të LMDHP-së, **me të dhëna personale** nënkuptohet çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues *online*, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik. Në kuptimin e kësaj dispozite, dosja e tenderit nr. 214-22-10936-5-1-1 136, me titull: Ndërtimi i stacionit Policor Veri, Prishtinë ka përmbajtur të dhëna personale të subjekteve të të dhënave, përfshirë datëlindje, numra telefoni, e-mail adresa, gjinia, kombësia si dhe numra personal, të punësuarve të kompanisë “ASTRAPLAN”.

Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, publikimi i të dhënave personale nënkupton përpunim të të dhënave. Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, Ligji në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të LMDhP-së, përcakton se me përpunim nënkuptojmë çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me

mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Bazuar në LMDhP, përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë i ligjshëm.

LMDhP, në nenin 4 ka përcaktuar parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhet respektohet me rastin e përpunimit të të dhënave personale, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i kufizimit të qëllimit, parimi i minimizimit të të dhënave, parimi i saktësisë, parimi i kufizimit të ruajtjes, parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit dhe në fund parimi i llogaridhënies, i cili përcakton se kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje të zbatojë përputhshmërinë e të gjitha e të gjitha parimeve të përcaktuara si më lartë.

Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës përcakton se të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Parimi i ligjshmërisë, është një parim i rëndësie të veçantë për çështjen e bazës ligjore, pasi është një nga përbërësit kryesorë të nevojshëm që përpunimi të jetë i ligjshëm. Parimi i minimizimit të të dhënave, duhet të jenë adekuate, relevante dhe nuk duhet ti tejkalojnë qëllimet për të cilat janë grumbulluar ose përpunuar më tepër, ndërsa parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit parasheh që të dhënat personale përpunohen në atë mënyrë që garantojnë siguri të përshtatshme të tyre, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe ndaj humbjes, asgjësimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masa të përshtatshme teknike dhe organizative

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet, së paku, një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDHP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në përputhje me ligjin.

Në bazë të nenit 23 paragrafi 1, të LMDHP-së, duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit, si dhe rreziqet e mundësi ndryshimi dhe ashpërsinë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrolluesi zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar gatishmërinë për të demonstruar që përpunimi të kryhet në pajtim me LMDHP. Policia e Kosovës, në cilësinë e kontrolluesit nuk ka ndërmarrë masat e duhura të sigurisë së të dhënave personale të dosjes së tenderit, momentin që ka publikuar në web faqen e tyre dosjet me të dhënat personale të punëtorëve të “ASTRAPLAN”.

Neni 31 par.1 nën par.1.1,1.2 si dhe neni 2 parasheh që në rastet e përpunimit të të dhënave, duke marrë parasysh gjendjen e teknikës, shpenzimet e zbatimit dhe natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit si dhe rrezikun e mundësisë së ndryshimit, si dhe ashpërsinë për të drejtat dhe liritë e personave fizikë, kontrolluesi dhe përpunuesi zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm për rrezikun, duke përfshirë, ndër të tjera, sipas rastit: 1.1. pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale; 1.2. aftësinë për të siguruar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë në vazhdim të sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit ndërsa në nenin 2 parasheh në rastet e vlerësimit të nivelit të përshtatshëm të sigurisë duhet të merret parasysh veçanërisht rreziqet që paraqiten nga përpunimi, veçanërisht nga asgjësimi, humbja, ndryshimi aksidental ose i paligjshëm, deklarimi i paautorizuar ose qasja në të dhënat personale të transmetuara, ruajtura ose përpunuara ndryshe.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas shqyrtimit të ankesës, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 18.04.2025]

Zyrtar për Inspektim

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të inicojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh. Inicimi i konfliktit administrative nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- “Policia e Kosovës”,- Kontrolluesit.
- Arkivit të Agjencisë.